PROJEKTI:

NDERTIMI I HAPESIRAVE TE GJELBERTA DHE KAMPEVE SPORTIVE

TË ZONES LAPRAKË,

TIRANË

Lenda

Hyrje 3
Bazueshmeria ligjore. 3
I. Vend-ndodhja 4
II. Karakteristikat e projektit: 7
III. Përdorimi ekzistues I tokës së kërkuar nga projekti; 15
IV. G jendja e mjedisit në zonën ku propozohet projekti. 21
Biodiversiteti, flora e fauna. 21
Mbulesa bimore, (Flora). 21
Fauna 23
Përdorimi i biodiversitetit 24
Cilësia e ajrit 24
Te dhena mbi klimën 25
Cilesia e ujrave siperfaqesore 26
Zhurma 28
Pejsazhi dhe topografia 29
Aktiviteti qe dotëkryhet 30
Organizimi i punes. 30
IV. Ndikimet ne mjedis. 30
a)Mbetjet e ngurta. 30
b) Shkarkimet në ujrat sipërfaqesore e nëntoksore. 31
c) Ndikimet ne ajer. 31
d).Zhurmat. 31
dh). Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu 31
e) Ndikimet ne toke, ne klime, nefloren, faunen dhe gjeologjine. 31
ë) Ndikimi ne infrastrukturen urbane te zones. 32
f) Perputhshmeriame planin urbanistik rregullues te zones. 32
g) Ndikimi ne trashegimine kulturore. 32
V. Masat per mbrojtjen e mjedisit 32
Mbeturinat e ngurta 32
Ujrat e perdorura. 33
Ndikimi ne ajer. 33
Zhurmat. 33

Shfrytezimi i burimeve natyrore.....34
Kerkesat teknike, estetike e ekologjike 34
Parandalimi i rreziqeve.....35
V. Manaxhimi i mjedisit, monitorimi 37
Konkluzione. 43

Hyrje

Në kuadër të realzimit të projektit "Periferitë Urbane të Tiranes – komponenti infrastrukturor në zonën e Laprakes – FROT/AID 04/006/00", Drejtopria e Përgjithëshme e Ujësjelles Kanalizime, ka nisur procedure për pajisje me Leje mjedisore.

Sipas projektit do të realizohen nderhyrje rikualifikuese urbane qëse bashku me rehabilitimin e rrugeve përfshijnë një siperfaqe rreth 150 ha, si:

a. **Ndertmi i zonave të gjelberta dhe kampeve sportive në Bllokun nr. 1, Pallati nr. 6; Blloku nr. 2 Palati nr. 2; Blloku nr. 3, Pallati nr. 4.**
b. **Ndertimi i hapesirave të gjelberta në segmentin në Rrugën "Bajram Alia".**

Bazueshmeria ligjore.

Bazuar në Ligjin me nr.10440 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 7 "Procedurat e vlerësimit të ndikimitnë mjedis", pika 3, ky projekt përfshihet në shtojcën II, " Projektet që I nështrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis". Sipas natyrës së tij, projekti perfshihet tek pika 10 e kesaj shtojce,"Prodhime infrastrukturore ", çeshtja b "Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qëndrave tregtare dhe parkimet për makinat".

Strukturimi i këtij raporti është berë në përputhje me kriteret për ketë qëllim të përcaktuara në Kreun I, pika 1.2 si dhe të shtojcës I, të VKM nr.686,datë29.7.2015, për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dheprocedurës së transferimit të vendimi te deklaratës mjedisore".

I. Vend-ndodhja

Projekti do të zbatohet në lagjën laprakë të Tiranës, e cila shtrihet në veri të këtij qyteti, në anën e djathtë, e cila si e gjithë zona periferike po zhvillohet në mënyrë të vrullëshme në mënyrë të veçantë në dy dekadat e fundit në të gjithë elementet urban infrastrukturor.



Fig. nr. 1 Zona ku zbatohet projekti (ortofoto).

Fig. nr. 2 Pamje ajrore e vendit ku do te ndertohen zonat e gjelberta dhe kampeve sportive në Bllokun nr. 1, Pallati nr. 6; Blloku nr. 2 Palati nr. 2; Blloku nr. 3, Pallati nr. 4.

Kordinatat e vendodhjes

1 E 482861.54 N 4578459.53

2 E 482973.92 N 4578515.62

3 E 483035.80 N 4578480.59

4 E 483061.57 N 4578361.54

Fig. nr. 3. Pamje ajrore e vendit ku do te ndertohen hapesirat e gjelberta në segmentin në Rrugën "Bajram Alia".

Kordinatat e vendodhjes Zona B 1;

1 E 483019.31 N 4578146.26

Kordinatat e vendodhjes Zona B 2;

E 482951.03 N 4578135.24

II. Karakteristikat e projektit:

Zonat e gjelberta tek Blloku nr. 1, Pallati nr. 6; Blloku nr. 2 Palati nr. 2; Blloku nr. 3, Pallati nr. 4. si dhe hapesirat pranë palletave (B 1 e B 2) në segmentin në Rrugën “Bajram Alia”, janë tejet të demtuara, vende vende te çveshura nga çdo lloje bimesie, me vende te betonuara ku ka pasur kioska, me material inerte e mbetje etj. Në afersi të kateve të para ne ndonjë rast janë mbjelle drurë frutore ose dekorative, shkurre dekorative pa asnje sistem e sistem te rregullt.

Nisur nga gjendja e renduar egzistuese e zones tek Blloku nr. 1, Pallati nr. 6; Blloku nr. 2 Pallati nr. 2; Blloku nr. 3, Pallati nr. 4. si dhe hapesirat pranë pallateve (B 1 e B 2) në segmentin në Rrugën “Bajram Alia, objektivi kryesor i projekti është të bejë gjelberimin e ketyre zonave e ndertimin e kampeve sportive. Kjo do te behet sipas projekti ku janë paraqitur me një planimetri me detaje specifike me të gjithë elementet që duhet ti pergjigjen kërkesave të sotme për mjedise te gjelberta çlodhese e argetuese.

Punimet parapregaditore te ndertimit të zonave te gjelberta e kampeve sportive lidhen me domolimet e strukturave te mbetura prej betonimeve te vjetra, germime per sistemimin e vendit ku do do zbatohet projekti, largimin e elemnteve vegjetative te pamevojshem. Germimet shoqerohen me evadimi e një sasie të konsoderueshme të dherave e mbetjeve nga demolimet, kryesisht copera betoni, gure, dhera e sipas rastit toke me vegjetacion te degraduar e spontan.

Siperfaqet e gjelberta do te kufizohen sipas rastit me bordura betony, dhe koridore qarkulluese me pllaka. Do te vendosen stola per banoret e frekuentusit e zones se gjelberuar. Zona do te jetë e pajisur me nje ndriçim të përshtatshem dekorativ e bashkekohor, me ndriçues te kohes qe shpenzojne minimalisht enërgjinë elektrike.

Sipas projekti shtresa e punueshme do të duhet të ketë karakteristikat fiziko-kimike për të siguruar një zenie te sigurt dhe zhvillimin e bimëve barishtore, shkurrore apo pemë. Duhet të jetë e pH neutral, të pajisur mire me materie organike dhe ushqyesve, cilësi të mesme, pa gurë, mbeturina, rrënjët e barërat e këqija. Ajo duhet të vijë nga burime të tokës bujqësore, dhe për të arritur një thellësi maksimale prej një metër. Kur shtresa është bërë nga toka jo te kultivuara, thellësia e tërheqjes se materialit duhet të jenë të e përfshirë në shtresën e eksploruara nga rrënjët e specieve barishtore të pranishme dhe në çdo rast nuk duhet të kalojë një gjysmë metër.

Kompania para se të marre dherat e ti shperndaje për shtrese, duhet të mostrat në një Station agrokimik te njohur, për të berë analizat conform standarteve per parametrat e analizës së tokës.

Sipa projektit, kompania, me shpenzimet e veta, do të duhet të kryeje analiza kimike e tokave për të përcaktuar të siguruar e zgjedhur llojet e plehrave qe duhet trajtuar si plehrat fosfatike, të azotiti dhe kriprave te kaliumit.

Në kohën e mbjellje do të duhet të jepen plehrat fosfat dhe kripë potasiumi, plehrave azotike për te siguruar mbirjen. Kjo pastaj do të vazhdojë për mbjelljen e bimëve nga bar shumëvjeçar me përdorimin e 200 kg farë për hektar të sipërfaqes.

Druret

Ata duhet të kenë pjesën ajrore të mbajtur në formë të rregullt, të ngjashme me druret e rritur në mënyrë spontane, për të nxitur një rritje të fuqishme, të shpejtë duke e vaditur e pleheruar.

Pemët do të duhet për të përmbushur specifikimet e përcaktuara në listën e çmimeve në lidhje me pikat e mëposhtme (që do të përdoren të gjitha ose pjesërisht, në përputhje me karakteristikat e saj e llojeve të ndryshme):

- Perimetrin i trungut;
- Lartësinë totale;
- Lartësia e deges me te ulëtt;
- Diametri i kurorës në degëzime;
- Dendësia e gjetheve, numri mesatar i degëve anësore në trung.

Bimët do të transplantuar disa herë të mjaftueshme në bazë të rregullave të mira çerdhe me punën e fundit në rrënjët, jo më të vjetër se tre vjet, sipas tabelës së mëposhtme.

Nxjerrjen e bimëve nga fidanishtja duhet të bëhet me të gjitha masat e nevojshme për të shmangur dëmtimin e rrënjëve kryesore dhe në përputhje me teknikat e duhura për të ruajtur sistemin e gjerë rrënjor dhe për të shmangur dëmtimet. Nxjerrja kryhet me dorë ose në mënyrë mekanike .

Mbjelljen nuk duhet të kryhet në periudhën e ngricave. Përveç kur parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta të kontratës dhe kushteve, mbjelljen e pemëve është në mes të mes të Tetorit dhe mesit të Prillit. Disa teknika mbjelljen lejojnë për të mbjellë në të gjitha stinët (enë, pllaka të paketuara në fletë plastike ngrohjes mbyllur, etj).

Përgatitja para mbjelljes

Në qoftë se duhet të behen shkurtime të nevojshme të pjesës ajrore të bimës, kjo do të duhet të kryhet në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër në mes të vëllimit të rrënjëve dhe grupin e degëve.

Mbjellja e drureve duhet te behet me tutore per ta mbajtur drejt trupin gjate rritjes ne vitet e para.

Përveç kur parashikohet ndryshe ne kontarte, sasitë e përafërta të ujit për ujitje janë:

- 40/50 litra per drurë;

- 15/20 litra për shkurre.

Hapja e gropave për drurët e rritur (me trungun me perimeter të paktën 18 deri në 20 cm) dhe haloret të paktën 3 m në lartësi: 1m x 1m x 1m;

- Druret e rinj: 0.7 m x 0.7 m x 0.7 m

- Shkurre: 0.50 m x 0.50 m x 0.50 m;



Planimetria e zones ne Bllokun nr. 1, Pallati nr. 6;



Legjenda

- Ndriçuesit e zones se gjelbert
- Çezme uji
- Kalimit te kabllove
- Kalimi i rrjetit hidrik

Planimetria eBllokut nr. 2 Palati nr. 2;



Planimetria Blloku nr. 3, Pallati nr. 4.

Planimetria e B 1 Rruga Bajram Alija

Legjenda

- Ndriçuesit e zones se gjelbert
- Çezme uji
- Kalimit te kabllove
- Kalimi i rrjetit hidrik



Planimetria e B 2, Rruga Bajram Alija

Në zonat e gjelberuara do të aplikohen ndriçues ne shtylla 3 m dhe tek kendet sportive 8 mm e spesor δ=4m.Ndriçuesit do jenë me teknologjine të zgjedhura qe kursejne energjine ne krahasim me egzistuesen. Linja e ndricimit do të jetë me trase nëntokësore me tub plastik fleksibël me dyshtresa ∅=90mm për kalimin e kabllit të furnizimit me energji elektrike dhe tubçeliku ∅=110 mm për rastet e intersektimeve. Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brënda përbrënda 40x40x40cm. Panelet e komandimit tëvendosen të rinj me komandim me fotoelementë. Energjia i rrjetit të ndriçimit do të merret nga kabinat egzistuse të zones. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndricimit te zones te cilet do ushqehen me ura të veçanta nga tranformatori egzistues. Në kabinë eshte parashikuar dhe vendosja e matësve të energjisë.

III. Përdorimi ekzistues I tokës së kërkuar nga projekti;

Projekti do të zhvillohet në zonën e Laprakes së qytetit të Tiranës. Tirana, kryeqyteti i Shqipërise shtrihet 110 metra mbi nivelin e detit, në anë përëndimore të Malit të Dajtit (1611m), në një rrafsh i cili përshkohet nga lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Qendrën e Tiranës e përshkon përroj i Lanës cili drejt grykëderdhjes bashkohet me lumin Ishëm. Tirana ka një sipërfaqe 41,8 km². Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët.Qyteti i Tiranës gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim.

E gjithë zona ku zbatohet projekti, zona e Laprakes,është tëresisht e urbanizuar, dhe projekti ka si objektiv të rikonstruktoje rruget e parashikuar sipas projektit me të gjithë elementet infrastrukturor që lidhen më trupin e rrugës.



Figura nr. 4Pamje ajrore e zonave A1, A2, A3, që do te gjelberohen.

Fig. nr. 5 Gjendje e mjedisit ne zonen A. 1.

Fig. nr. 6 Gjendje e mjedisit ne zonen A. 2.

Fig. nr. 7 Gjendje e mjedisit ne zonen A. 3.

Fig. nr. 8 Gjendje e mjedisit ne zonen B. 1.

Fig. nr. 9 Gjendje e mjedisit ne zonen B. 2.

IV. G jendja e mjedisit në zonën ku propozohet projekti.

Biodiversiteti, flora e fauna.

Zona ku parashikohet rikualifikimi urban është terren fushor. Struktura e tokes përgjithsisht eshte argjilore, me cilësi të mira për ndertime. Zona rreth objektit dhe vetë objekti është në një zonë e zhvillimit urban të ketij qyteti e në një trysni në rritje për një zhvillim intensiv për aktivitete të ndryshme.

Kjo zone është e dominuar nga zhvillimi urban dhe nuk mbartë vlera të veçanta të biodiversitetit që mund të merren në konsideratë gjatë rikualifikimit. Bimësinë natyrore në zonëështë është kondicionuar nga niveli i ulet i terrenit, cilësitë edafike, nga prania jo shume e afërt nga ana veriore e lumit të Tiranës, si dhe potenciali i ulët i ujrave nëntoksore.

Mbulesa bimore, (Flora).

Duke qënëzonë më zhvillim urban, bimësia nuk ka një fizionomi të dallueshme në vendet që nuk është trajtuar me gjelberim të kultivuar, por është e veshur me bimësi të ulët me vatra spontane dhe që është e zakonshme në mjedise të tilla.

Ne vende te patrajtuara me infrastrukture urbane te zonave qe parashikon projekti, buze rrugeve te pashtruara, gjenden e Mellaga e eger (Malva sylvestris L.), trasta e bariut (Capsella bursa-pastoris), nejca piper uji (Polygoniun hydropiper L.), çikorja ose radhiqja, (Cichorium intybus L.), laboti heshtak (Atripleks hastatum L.),nejca me gjethe pjeshke (Polygonum persicaria L.), lepjeta e kopshtit (Rumex patientia L.), zhabina e arave (Ranunculus arvensis L.), fomi mjeksor (Fumaria officinalis L.), agrimonia (Agrimonia eupatoria L.), zorreca (Potentilla reptans L.), terfili i verdhe (Trifolium campestre), grami zvaranik (Agrypyrum repens L.) akilega (Aquilegia vulgaris L.) etj.

Ne hapesira buze banesave, familjaret kane mbjelle shkurre dekorative, drure dekorativ si rrapi (Platanus orientalis), selvi (Cumpressus sempervirens) lajfata (Cercis siliquastrum), drure frutor te kultivuar si pjeshka (Prunus armeniaca), lajthia (Corylus avelana L.),kumbulla (Prunus domestika), hardhia (Vitis vinifera), ulliri (Olea europea L.).

Në përiferitë e qytetit, në ketë zonë, ku urbanzimi nuk ka kete dendesi ose mungon, nëbimësinë që gjendet në kanalizime drenuese e zonës e në litorale të paprekura nga njeriu, dallohen bimët si bargjaku (Lythrum salicaria L.) bimë të familjeve graminore si kuqela e ravenes (Erianthus ravenua P.B.). Në terren ku ka prezence lagështirë takohen bimë të tilla si mendra (Menta piperita L.) mendra gjethegjate (Mentha longifolia L.), menta e eger (Menta pulegium L.) menta e ujit, (Menta aquatica). Janë të instaluara gjithashtu sidomos ne vendet me te ngritura dhe bimet e familjes se

kompoziteve si thundermushka (Tussilago farfara L.), kamomili i qenit (Anthemis cotula), cikorja (Cichorium intybus L.), lule dhensh (Bels perenis L.) e bime te tjera si hermana, (Rubus fruticosa L.), kin fushe (Erithrea centarium), Podiqja e eger (Agrimonia eupatoria), terfili i arave (Trifolium arvense) etj.

Fig. nr. 10 Gjelberimi spontan tek zona A.2.

Fig nr. 11 Bimesia spontane dhe e kultivuar tek zona B 1.

Fig nr. 12 Bimesia spontane dhe e kultivuar tek zona B 2.

Fauna

Në koridore më pak të trazuara nga njëriu e në periferi nga ana veriore mund të takohet rrallë lepuri i eger (Lepus europaeus),*Plecotus auritus* (lakuriqi veshgjatë) *Nyctalus noctula* (lakuriqi i natës) ndersa brejtesit janë me evident afër ndertimeve rezidenciale e veçërisht në kanalizimet.

Ne avifaunen e rajonit në shqyrtim bejnë pjesë shpende të mjedisit urban si dhe ato karakteristike te shkurretave si Anthus campestris, Corone cornix, Corvus corax, Pica pica, Passer domesticus, Carduelis carduelis, etj. Takohen gjithashtu gargulli i zi (Sturnix vulgaris), lauresha (Aleuda arvensis), mellenja (Turdis merula), trishtilat, harabelat, gushkuqet etj.

Veçanërisht në tërrene më të thata, reptilet janë më të pranishëm si Lacerta viridis, *Lacerta trilineata (hardhucë e gjelbër me tre vija),* Podarcis muralis, Anguis fragilis, *Natrix tesselata (gjarpër)* e breshka e zakonshme (Testudo hermani,).

Prania lumit të Tiranës nëanën vëriore të zonës në studim ka favorizuar veçanërisht në dy anët e tij si dhe ne kanalet kulluese praninë e amfibëve si bretkosen e zakonshme (Rana ridibundo Pall), thithlopen e zakonshme (Bufo bufo), thithhlopen e gjelbert (Bufo viridis Laur).

Përdorimi i biodiversitetit

Zona ku planifikon projekti nuk është zonë e mbrojtursipas kriterve të IUCN-sëaposipas legjislacionit shqiptar për zonat e mbrojtura e biodiversitetin. Potencialet faunistike e floristike nuk janë përdorur në mënyrë të planifikuar ose për qëllime të veçanta nga subjekte të ndryshme qoftë dhe për bimë mjeksore në territorin ku planifikohet të behët rikualifikimi urban, në zonën e Laprakes.

Cilësia e ajrit

Emetimet ndotëse me të evidentueshme në ajër janë ato të trafikut i cili ka një fluks në rritje dhe veçanërisht në periudhën e verës duke u ndikuar nga shkarkimet e produkteve te djegjes se karburanteve nga motorët e automjeteve. Veç kësaj pluhurat veçanërisht nga aktiviteti ndertues janë një tjetër element potencial ndotës i ajrit.

Qyteti i Tiranës, veçanërisht si rezultat i rritjes se trafikut të automjeteve dhe intesifikimit të aktivitetit ndertimor është verejtur përkeqësim i cilesisë së ajrit. Përfundimi i projektit për rikualifikim urban të kësaj zone, kontribuon në përmirsimin e e cilësisë së ajrit.Nga monitorimi i cilësisë së ajrit sigurohen të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, për të dhënatmeteorologjike, ndikimet në shëndetin e popullates.

Nga AKM-ja, në mënyrë periodike bëhën matjet e cilësisë së ajrit për Tiranën (dy stacione) si dhe për qytetet e tjera kryesore për PM10, PM2.5, NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX.

Nder treguesit kryesor te monitorimit janëgrimcat e pluhurit (PM) që janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 mikrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO2, NOx, NH3 dhe NMVOC PM.

Evidentimi i niveleve të PM-ve nëpërmjet monitorimit ka rëndesi të veçantë për marrjen e informacionit sensibilizmin e marrjen e masave pasi grimcat e pluhurit janë një nga ndotesit e ajrit që mund të shkaktojnë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zemrës dhe mushkërive, goditje në zemër dhe aritmi e mund të dëmtojnë sistemin nervor qëndror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojnë kancer.



Grafiku i matjeve për vlerat mesatare vjetore për PM10

Bazuar dhe ne rekomandimet e raportit per gjendjen e mjeedisit ne Shqiperi per fitin 2014 përmirsimi i cilesisë së ajrit urban do të varet dhe nga tregues që lidhen me zbatimin e projektit për ketë zonë si:

- Zvogëlimin e numrit të makinave nëpërmjet përmirësimit të transportit publik
- Manaxhimi i rrjetit rrugor dhe trafikut
- Promovimi i përdorimit të bicikletave
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe larja e rrugëve

Te dhena mbi klimën

Zona e projektit përgjithësisht mbizotërohet nga erërat që vijnë nga anët veriperëndimore dhe juglindore të Tiranës e që gjatë periudhës së verës ndjehet në formën e flladit freskues detar.

Koha me diell përbën mesatarisht 2221 orë/vit, nga të cilatkorrikut i përket numri më i madh dhe dhjetorit më i vogli.

Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin, ndikojnë në kushtet klimatike të zonës. Temperatura mesatare e ajrit varion nga 6,4^{o}C, në muajin më të ftohtë (Janari), deri në 22,0^{o}C, në muajin korrik. Temperaturat maksimale mesatare variojnë nga 11,2^{o}C, deri në 31^{o}C në muajin gusht.

Temperaturat mesatare minimale variojnë nga 1,4^{o}C, deri në 16,4^{o}C. Temperatura minimale absolute është –10,0^{o}C, në janar të vitit 1968 dhe ajo maksimale absolute 40,5^{o}C, në muajin korrik të vitit 1973.

- Reshjet

Për shkak të aktiviteteve ciklonike, shpërndarja e reshjeve është afërsisht e njëjtë ndërmjet periudhës së ftohtë dhe asaj të ngrohtë të vitit. Sasia vjetore e reshjeve është 1200 mm/vit, nga të cilat 57,2% bien në gjysmën e ftohtë të vitit.

- Era

Te dhenat per shpejtesine e eres per rajonin jane:

30 m/sek: një herë në çdo 10 vjet

33 m/sek: një herë në çdo 20 vjet

38 m/sek: një herë në çdo 50 vjet

Cilesia e ujrave siperfaqesore[1]

Zona e Laprakes ndodhet në veri të qytetit të Tiranës, ndersa me ne veri të kesaj zonë ndodhet Lumi i Tiranës. Ky lum bën pjesë në basenin Ishëm – Erzen dhe monitorohet në dy stacione, (stacionet Ura e Brarit dhe ura e Kamzës), si dhe ne 5 stacione të tjera që ndodhen ne lumin Lanës, lumine Ishmit. Ky lum është në ndikim të plotë të shkarkimeve urbane dhe industriale të zonës ku kalon si dhe nën një presion mjaft të lartë në krahasim me stacionet e tjera të rrjetit të monitorimit nëtë ujërave sipërfaqësore të vendit. Monitorimi bazohet bazohet ne tete parametrat me kryesore te ndotjes kimike te percaktuara ne Direktiven Kuader te Ujit te BE. Ujerat e lumenjve për vendin tonë vleresohen alkalin me pH nga 7. 5-8. 3 dhe ne vlera brenda normes se lejuar (< 8. 5).

Nga monitorimi i**përmbajtjes se oksigjenit** me afer zonës se projektit vleresohet të jetë nje sasi të pakët të oksigjenit në stacionin L2 (ish dogana) ku lumi i Lanës paraqitet në gjendje të varfër ose cilësi e IV, si pasojë e shkarkimeve urbane të qytetit të Tiranës. Në tre stacionet e lumit Ishëm vlera e oksigjenit të tretur është pothuajse konstante nga 5. 6-5. 9 mg/l dhe klasifikohen të cilësisë së tretë, gjëndje e moderuar.

Ndersa permbajtja **e nevojës biologjike** për oksigjen, në dy stacionet T2 -ura Kamëz dhe L2- tek ish dogana, që ndodhen pas shkarkimeve të ujrave urbane të patrajtuara të qytetit te Tiranes, permbajtja e NBO5 rritet ne vlera shume te larta, duke tejkaluar dhe nivelin e cilesisë me të keqe, klasa e pestë. Po kështu situata paraqitet problematike edhe edhe në tre stacionet e lumit Ishëm (cilësi e pestë dhe të katër) për stacionin e fundit në Ishëm. Shkaqet për keë gjëndje janë shkarkimet e lengeta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve.

Nga monitorimi i përmbajtjes se **nevojës kimike për oksigjen** situata paraqite problematike tek lumi i Tiranës në stacionin Ura e Kamzës, lumi i Lanës në stacionin L2 (ish dogana) qëndodhen pas kolektorëve të ujerave urbane të patrajtuara të qytetit të Tiranës ku niveli i ndotjes është mjaftë i lartë, (T2- ura Kamëz 42 mg/l dhe L2- tek ish dogana 94 mg/l).

Referuar rezultateve për përmbajtjen e fosforit total po ne keto dy stacione me të aferta me zonën e projektit (T2 -ura Kamëz dhe L2- tek ish dogana), që ndodhen pas shkarkimit të kolektoreve të ujerave urbane të patrajtuara të qytetit të Tiranës, përmbajtja e fosforit total rritet në vlera shumë të larta, 0. 55 mg/l në stacionin T2 dhe 1. 49 mg/l në stacionin L2. Keto shkarkime permbajnë dhe tretesira detergjentësh me permbajtje fosfori, ende në përdorim nga shume

[1] Te dhenat per cilesine e ujrave siperfaqesore i referohen Raportit per Gjedjen e Mjedisit ne Shqiperi te AKM.

perdorues familjare dhe industrial. Si rrjedhoje cilësia e ujerave të lumit të Tiranës klasifikohet në cilesinë më të ulet, të varfër - në të keqe.

Përmbajtja mesatare ne këto stacione e nitriteve (NO2) varion nga 0. 075-0. 05 mg/l që vleresohen me një rritje që i afrohet vlerës limite.

Ndersas permbajtja mesatare e NH4 varion nga 1.708- 13.175 mg/l duke tejkaluar disa here normen e gjendjes se moderuar, cilesine e trete. Vlera me e larte paraqitet tek Ish dogana qe ndodhet pas shkarkimit te kolektoreve te ujerave urbane, te cilat jane pergjegjese direkte per vlerat e larta te permbajtjes se amonjakut.

Përmbajtja e nitrateve (NO3) ne ujerat e lumenjve eshte e ulet ne krahasim me normen e cilesise se mire.

Rezultatet mesatare të monitorimit në vite tregojnë për një ndikim te dukshëm dhe të qendruëshem të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujerave të lumenjve.

Temperatura e ujit të lumenjve ka një shpërndarje vjetore sipas stinës ne perputhje me temperaturat e ajrit dhe varion nga13. 9-20. 6 0 C. Në krahasim me një vit më parë nuk kemi ndryshime në ecurinë vjetore të temperaturës së ujërave të lumenjve.

Eshte evidente se permiresimi i situates mjedisore te ujerave siperfaqesore kerkon realizimin e investimeve ne drejtim te trajtimit te shkarkimeve te lengeta urbane, sidomos ne Tirane.

Respektimi i standarteve te percaktuara nga legjislacioni shqiptar per shkarkimet e lengeta nga subjektet prodhuese ne ujerat prites siperfaqesore merr rendesi te veçantë si dhe kontrolli i vazhdushem ne zbatimin e ligjit.

Ujrat nentoksore si pasuri e madhe kombetare janëobjektshfrytëzimiivazhdueshëmmeintensitetnë rritjedhemerisktëpërhershëmndotjengaveprimtaritënatyroreehumane.

Vlerësimiicilësisësëtyrenëpërmjetmonitorimitgarantonruajtjenerezervavetëshfrytëzimittëujërave nëntokësorë, mbrojtjenevendburimeve ekzistuesetëujit,vlerësonshkaqetendotjes sëtyre. Mbi ketë bazë përcaktohen masatpërzbatiminezonavetëmbrojtjessa me korekte sanitare.

Nga monitorimet janëvleresuarekrahasuar përmbajtjete treguesve ndotës si NO2, NO3, NH4 dhe tregues vetë tjerë Na,Ca,Mg,Fe,Cl,SO4,Fp,pH,Mp, me standarte te vendit dhe të Bashkimit Europian. Sasia e ujit që shfrytëzohet në **Akuiferi ujë mbajt e si zhavoreve të Tiranës** është rreth 1200-1300l/sek, përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit tëTiranës,Vorës,Kamzës dhe qendra te banuarasidheujë teknologjik. Akuiferi ujëmbajtes i zhavoreve të Kuaternarit tëTiranës monitorohet me një rrjet monitorimi me 5 shpime**.**Koeficenti vjetor i shfrytëzimit në Tiranë varion K = 0, 85 - 0. 95. **Temperatura e ujit T** - Temperatura e ujit në tre fazat e monitorimit varion T = 16. 7 – 18^0 Celsius, temperatura mesatare është 17. 21^0Celsius (norma 8 - 15, deri 20). Ndersa **pH i ujrave netoksore** në tre fazat e monitorimit varion 6. 91 - 7. 30, sipas normës së lejuar për ujë tëpijshëm ky tregues është brenda normës (pH = 6, 5 - 8, 5). Sipas vlerës së pH vleresohen te jenëujra të tipit alkalin të dobët me ph = 7 - 9. Vlera mesatare e pH për vitet2010 - 2014 varion 7. 18 - 7. 35.

Fortësia e Përgjithshme Fp - Fortësia e Përgjithshme në tre fazat e monitorimit varion Fp =

17 05-27. 5 ogjermane, tregues brenda normes deri pak mbi normë në shpimin nr. 47 Bërxullku FP varion Fp = 26. 38 - 27. 52 ogj, tregues brenda normes së lejuar deri mbi normë në njëanalizë në shpimin nr. 47 Bërxull ku Fp arrin 27. 72 ogjermane.

Mineralizimi i përgjithshëm Mp - Mineralizimi i përgjithshëm në tre fazat e monitorimit varionMp = 581. 01 - 857. 58 mg/l, janë brenda normës së lejuar. Përmbajtja e Natriumit në tre fazat e monitorimit varion nga 29.44- 79. 12 mg/l. Përmbajtje është brenda normave te lejuara dhe standerteve te BE.Ne permbajtene e Ca, Mag, Fe, NH_4, SO_4, NO_3, NO_2, O_2 nuk verehen problematika te veçanta qe lidhen me aspekte specifike mjedisore apo me riskun e ndotjes.

Zhurma

Standardet e zhurmës të aplikuara zakonisht, të tilla si pragu i OBSH për shqetësimin e njerëzve gjatë natës është 45 dB(A). Nga rikualfimi urban i zonës së Laprakes sipas ketij projekti priten të ulet niveli i zhurmave të tanishme në zonën e planifikuar të projektitdhe për arsye të një menaxhimi më të mirë të trafikut e kushteve të reja të përmisuara të rrugeve. Kontribut të veçantë përmirsues në uljen e nivelit të zhurmave do të jetë dhe nga ndertimi e zhvillimi i zonave të gjelberta si rezultat i zgjidhjeve të projektit.



Tabela 6. Paraqitja tabelore e vlerave mesatare të ditës, LAeq/Ditën, për 15 pika monitorimi në qytetin e Tiranës, në 5 vitet e fundit të monitoruar.[2]

[2] Te dhenat jane marre nga Raporti i gjendjes ne mjedis ne Shqiperi te AKM per vitin 2014.

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Laprakë	72	74.4	71.6	72. 9	72. 5
IshBlloku (B.A.)	70	64.9	61.4	60.9	62.9
StandartiiBe					**55**

Tabela 7. Paraqitja tabelore e vlerave mesatare të natës, LAeq/Natën, për 15 pika monitorimi

në qytetin e Tiranës, në 5 vitet e fundit të monitoruar.[3]

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Laprakë	57	63. 6	63. 1	63. 2	61. 8
IshBlloku (B.A.)	62	59. 3	60. 5	63. 1	60. 6
StandartiiBe					**45**

Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike. Kuadri ligjor, i politikave, planeve etj

Në vendin e përfshirë për kualifikim parësor për rruget në zonën Laprakë të Tiranës, rrugen "Bajram Alia", rrugen "Learton Vathi", rrugen "Bujar Kaloshi", rrugen "At Zef Valentini"nuk ka objekte që të ketë vlera të trashëgimisë arkitektonike e historike, si dhe nuk është zonë arkeologjike. Në këtë vështrim nuk ka objekte monumente të natyrës, monumente të kulturës e objekte apo zona që të mbrohen me ligj. Nuk vërehet ndonjë objekt që të preket nga projekti e që mund të kërkohet të merret në mbrojtje për arsye të vlerave që mbart e trashegon.

Nga verifikimet evidentohet se edhe zona rreth objektit që do të ndertohet nuk klasifikohet dhe nuk përfshihet në asnjë zonë me status ligjor të veçantë mbrojtës që të ndikohet nga projekti. Konsultimi me të gjithë aktoret e interesuar dhe procesi miratues i projektit evidenton përputhshmërinë e objektit të planifikuar me planet e zhvillit të kësaj zone, konform kuadrit ligjor.

Gjithashtu projekti i propozuar nuk ndikohet nga marëveshje nderkombëtare, koventa etj.

Pejsazhi dhe topografia

Sheshi i planifikuar është pothuajse i lirë, truall për ndertim, si pjesë një pejsazhi urban qytetas me intesitet ndertues. Në zonën e projekti vërehen tendenca të ndertimeve me elemente aqitekturore e konstruktiv bashkëkohore duke e prezantuar si pejsazh me prirje gjithnjë e me modern të kësaj pjesë të qytetit. Zona nuk ka atraksione të tjera të veçanta pejsazhiste ose karakteristika të tjera topografike që të favorizonte e impononte drejtime të tjera specifike zhvillimi për ketë zonë në urbanizim.

[33] Te dhenat jane marre nga Raporti i gjendjes ne mjedis ne Shqiperi te AKM per vitin 2014.

Aktiviteti qe dotëkryhet

Projekti do te realizohet sipas fazave te punimeve per çdo objekt, kudo te perfshihen te gjithe zerat epunës. Gjate punimeve do te nevojitet që trafiku do te bllokohet sipas rasteve të specifikuara për çdo objekt duke e adresuar ne drejtime te tjerate mundeshme të planifikuara me parë duke e shpërndarë atë në mënyrë sa më uniforme.

Të gjithë elementet ndertimor të objekteve duhet të merret për sipër nga firma të liçensuara për aktivitet të tillë e me eksperiencë në realizimin e objekteve të ngjashme e në plotësimin e kritereve teknike e ligjore gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

Gjatë zbatimit të projektit do të përdoren matëriale të ndryshme ku përfshihen edhe ato metalike të parapregatitura sipas projektit si shtyllat ku instalohen ndriçuesit.

Rikualifikimi i rrugeve të zonës së Laprakës do ndikoje në një rritje të cilësisë të të gjithë elementeve infrastrukturor që trupezohen me rrugët, për një jetë me komode për komunitetin, do të rrisi sigurinë përkalimtarët e automjetet, do të ndikojë në lehtësimin e trafikut të qytetit, përmirsim të cilësisë së ajrit e do ndikojë pozitivisht në peisazh.

Organizimi i punes.

Punimet në objekt duhet të bëhet nga firma të liçensuara dhe puna do të jetë organizuar kryesisht në nje turn, nga ora 08.00-16.00.

Të evitohen në maksimum rastet e nderprejes se furnzimit me enrgji elektrike ose me ujë të konsumatoreve dhe në raste të tilla ato duhet të njoftohen me parë.

Gjatë gjithe periudhës së kryerjes se aktivitetit e ne te gjithë vendin ku punohet duhet te vendosen të gjitha tabelat treguese e sinjalizuese e shirita kufizues e orientues të levizjeve, për sigurinë në punë gjatë fazës së zbatimit te projektit. Po kështu ngarkohen punojes sipas rastit për të komunikuar me kalimtaret e drejtuesit e automjeteve për qëllime sigurije të jetes se tyre e të pronës. I gjithë aktiviteti organizohet dhe ne bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe sipas rastit me përfaqesues te subjekteve te albetelekomit e ujesjellesit si dhe nga administratoret e objekteve publike.

IV. Ndikimet ne mjedis.

a)Mbetjet e ngurta.

Gjatë punimeve do të evidentohen si mbetje te ngurta nga punimet pregatitore te objektit, elemente betoni e fragmentet e vjetra ndertimore, dhera, pjesë metalike, masa vegjetative etj.

Aktiviteti ne zbatimin e ketij projekti nuk ka të bëjë me shëndrrime potenciale të lëndeve të ndryshme ndertuese e që të shoqërohet më formime të mbetjeve të tjera ose të emetimeve me natyrë ndotese.

b) Shkarkimet në ujrat sipërfaqesore e nëntoksore.

Aktivitetet ne zbatimin e ketij projekti nuk kanë të bëjë me shëndrrime të lëndeve të ndryshme e që të shoqërohet më administrim të substancave të lengeshme ose ujrave të përdorshme e që të krijojë situata nën rrisk për ndotje të ujrave sipërfaqësore e nëntoksore. Sistemimi I mjediseve urbane I realizuar nga projekti do të ndikoje pozitivisht ne percjelljen e ujrave dhe zbutjen e ndotjeve te krijuara me pare.

c) Ndikimet ne ajer.

Shkarkimet ne ajër ndodhin gjatë kohës kur kryhen veprime operacionale ndertimore kur aktivizohen automjetet, nga emetimi I produkteve të djegies të karburantit nga motoret. Keto emetime konsiderohen brenda standartevetë lejuara pasi dhe automjetet duhet të plotësojnë kritere te të mos jenë të amortizuara. Produkte te djegies se karburantit gjate qarkullimit e manovrave të automjeteve jane te zakoneshme dhe punojnesi te tilla vetem ne mjedise te hapura. Perqendrimi I ketyre emetimeve eshte normal, i krahasueshem me nje mjediste tille te hapur. Asfalti sillet i gatshem per tu perdorur ne shtrimin e rruges dhe ndikimi ne ajer eshte minimal. Gjate aktivitetit nuk ka asnje proçes tjeter shkarkimi ne ajer.

Punimet për largimin e dherave gjate hapjes se shtratit ku realziohet rruga kanë të bëjnë më gërmimë e evadimi dherash. Keto shoqerohen me emetime të pluhurave në mjedis për të cilat duhet të merren masa rigoroze ne minimizimin e shkarkimeve gjatë këtij procesi pune.

d).Zhurmat.

Aktiviteti ka të bëjë vetëm me zhurmat që shkatohen nga automjetet gjatë levizjës për transport të matërialeve gjatë punimeve ne objekte dhe largimit të materialeve te ngurta te pa perdoreshme. Duhet berë kujdes për respektimin e nivelit të lejuar të zhurmave pasi objektet ndodhet në zona më ndertime të institucioneve rezidenciale e të sherbimeve. Duke qënëse në afërsinë e objektit ka ndertime për banim e sherbime, duhet treguar kujdes që të mos shkaktohen zhurma në ato përiudha kohore që mund të shqetësoje komunitetin përrreth.

dh). Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu

Realizimi I objekteve si pas projektit do të ndikojë në sigurinë e levizjes e automjeteve si dhe kalimtareve e në lehtësimin e levizjeve në të dy drejtimet,në mos bllokimin e trafikut, permirsimin e ndjeshmet e peisazhit urbane te cilesisese mjedisit ne pergjithesi. Projekti i rikonstruktimit të rrugeve do të jap një ndikim të madh pozitiv në objektet qe janë pjesë e zhvillimit urban duke rritur në mënyrë të ndjeshme komoditetin e të jetuarit për të gjithë komunitetin e kesaj zonë.

e) Ndikimet ne toke, ne klime, nefloren, faunen dhe gjeologjine.

Aktivitetet sipas projektit respektojnë standartet ndertimore te miratuara që kanë të bëjnë me cilësinë e terrenit, ndertimin gjeologjik, e klimen. Objektet gjithashtudo te realizohet ne një

zone tërësisht të urbanizuare cila ka nje profil urban, do ti nënshtrohet rikonstruksionit për rrugët dhe nuk do të ndikojnë në presione potenciale në florën e faunën.

ë) Ndikimi ne infrastrukturen urbane te zones.

Zbatimi i ketij projekti ka të beje me permirsimin e krejt infrastruktures në ketë zonë të qytetitsi rruget, trotuaret, parkime ne anë të rruges, kanalizimet, ndriçimet, mjedise te gjelberta, vendeçlodhese, tubacione uji, kabllo elektrik, etj. Rikualifikimii rrugeve të kësaj zone të qytetit ndikon në përmirsime të ndjeshme të përformancës urbane qytetit.

f) Perputhshmeriame planin urbanistik rregullues te zones.

Projekti ne fjale ka të bëjë vetem me rikualifikime rrugeve me të gjithë elmentet infrastrukturor përbërës per t'ju pergjigjur me mire nevojave te zhvillimit urban dhe eshte ne perputhje te plote me planin urbanistik rregullues.

g) Ndikimi ne trashegimine kulturore.

Projekti nuk prek ose ndikon ne objekte me vlera te veçanta historike ekulturore por përmirson dukshem vlerat e infrastruktures egzistuese. Zhvillimi i ketij aktiviteti ka lidhje direkte me ruajtjen e përmirsimin e trashegimisë ndertimore të objekteve të tilla infrastrukturore të rëndësishme.

V. Masat per mbrojtjen e mjedisit

Mbeturinat e ngurta

Mbeturinat e ngurta kryesisht dherat, copera nga asfalti, betonet, pllakat, duhet te dergohen ne vendin e caktuar per kete qellim nga bashkia e Tiranës për mbetjet ndertimore ose te perdoren si material mbushes ne ndertime. Kujdes duhet te tregohet ne transportimin e ketyre mbetjeve per te mos krijuar ndotje gjate transportit, por kerkohen karroceri të mbuluara e tesigurta. Mbetjet metalike e të drujta qe grumbullohen duhet tëtrajtohen në mënyrë specifike sipas rastit kryesisht duke i kaluar tek subjektet që i administrojnë ato dhe janë të shumtë. Aktiviteti nuk shoqërohet me ndikime ndotës në mjedis.

Per zbutjen e impakteve në tokë sherben sistemimi e organizimi i përshtatshemi mjedisitkukryhenpunimet.

Të gjitha mbeturinat, bazuar në kategorizimin sipas legjislacionit për mbetjet duhet të administrohen në përputhje më kriteret e përcaktuara në ketë legjislacion.

Gjatë këtij aktiviteti duhet te zbatohet me rigorozitet:

- Ligji me Nr.10 463, datë 22.9.2011, " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ” i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve;

- Rregullorja nr.1datë15.03.2006 “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore” e cila përcakton masat që duhet të zbatohen nga personi fizik ose juridik që ushtron veprimtari ndërtuese për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndikimet negative të saj;

- Per zbutjen e impakteve në tokë sherben sistemimi e organizimi i përshtatshem i mjedisit të punës. Firma zbatuese duhet të marri masa e përgjegjesitë për administrimin e përshtashëm të mbetjeve sipas rastit e natyrës së tyre.

Ujrat e perdorura

Nuk kemi asnjë përdorim të veçantë të ujrave që të shoqërohen me ndotje ose që përftohen si rezultat i një procesi teknologjik. Gjithashtu duhet treguar kujdes gjatë operacioneve ndertimore ne mos bllokimin e pusetave e te infrastruktures kufizuese te objektit ne ndertim, per mos bllokimet e perkoheshme qe te sjellin impak te negative ne mjedis.

Ndikimi ne ajer.

Aktiviteti i pershkruar me siper nuk shoqerohet me ndikimepotenciale ndotese ne ajer, i vetmi burim me timi të ndotesve në ajër janë automjetet gjatë kryerjes së transporti te ngarkim shkarkimit në objekt si dhe ato që do të frekuentojnë objektin gjatë vënies në fuksion të tij. Substancat ndotëse janë produktet e djegies së karburantit nga motorët e automjeteve.

Gjate zbatimit te projektit duhet të zbatohen me rigorozitet:

-Ligjinr.8897datë16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërti në e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotje te shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikëssë Shqipërisë;

-Udhëziminr.6527datë24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëstë ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra te kontrollit të tyre” i cili përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye;

Zhurmat.

Subjektit, rigorozisht i kerkohet respektimi i orarit te punes per te evituar zhurma te pa nevojshme e mbi normat e lejuara. Kjo kërkese merr rëndesi të veçantë pasi objekti ndodhet në një zonëmë ndertime kryesisht rezidenciale. Gjatë ndertimit duhet të zbatohet me rigorozitet kerkesa te:

Zhurmat që shkaktohen punimet me makineri e pajiseje, nga automjetet gjatë levizjes për transport të matërialeve janë të përkoheshme si të tilla. Pas rikonstruksionit do të

ulet niveli i zhurmave nga trafiku krahasuar me situaten e mëparshme për arsye të menaxhimit më ta mirë të trafikut, organizimit të parkingjeve, dhe të mundësisë më të mirë që afron për levizje të automjeteve rruga e rikonstruktuar. Kujdes duhet treguar gjithashtu që të mos shkaktohen zhurma në përiudhat që mund të shqetësoje në oraret e pushimit të banoreve apo në afersit të objeketeve publike kur janë të me tëfrekuentuara.

Gjatë veprimeve operacionale te nderhyrjeve sipas projektit duhet të respektohen kërkesat e :

- Ligjit me nr.9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;

- Udhëzimit me nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara" i cili përcakton nivelet e zhurmave në mjedise të caktuara, të cilat duhet të mbahen parasysh gjatë zbatimit të projektit sidomos per segmenet në afërsi të objekteve turistike që kanë frekuentues.

Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre" i cili përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye;

Shfrytezimi i burimeve natyrore

Aktivitete te projektit nuk ka të bëjnë me ndikim direkt në shfrytezimin eburimeve natyrore. Firma duhet të tërheqë atëriale ndertimore vetëm nga subjektet e liçensuara.

Kerkesat teknike, estetike e ekologjike

a- Masa teknike:

- Respektimi I kritereve teknike të operacioneve tëpunes ne objekte.
- Zbatimi I shesheve të distancave te sigurise prej elementeve të infrastrukturës së sheshit etj,
- Mbrojtja rigoroze e përmirsimi I saj.
- Respektimi i plotëi Regullores se SigurimitTeknik që lidhet dhe me menyren e zgjidhjeve teknike e zbatimit të tyre të të gjitha operacione vetëpunës.

b - Masa estetikee ekologjike

- Bërja kujdesnë respektimin e projektit i cili duhet të marrë parasysh respektimin e projektit ne të gjitha elementet e objektet. Zbatimi I zerave te projektit kanë të bëjnë permirsimet e dukshme në pejsazhin urban ne kete zone te rendesishme urbane tëqytetit teTiranës.
- Kontribut I rëndësishëm pozitiv në pejsazh urban është sistemimi teresor i rrugeve, trotuareve, sipas rastit e parkingjeve, elementet dekorues te rrugeve dhe ndriçimi për një mjedis urab modern e atraktive realizimi e një mjedi sipër një jetesë urbane me komode.

Parandalimi i rreziqeve

Për parandalimin e rreziqeve, aktiviteti duhet të mbeshtetet ne Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjen ne Punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatimin e tyre të lëshuar nga dikasteret përkatëse.

Subjekti duhettë percaktojësi detyre ligjore vendosjen e tabelave në vënde të dukshme dhe natën tëndriçuara me pjesët kryesore të rregulloreve të sigurimi tteknik, sigurimin e kushteve e mjeteve mbrojtese.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në pune do të jenë nder problemet me kryesore për subjektin gjatë gjithë fazës së zbatimit të projektit.

Situata te veçanta që mund te krijohen nga mos njohja e kushteve tekniket e punes, pa kujdesi te e ndryshme kërkojnë një vlerësim maksimal të masav e mbrojtese e respektimin e rregullores se sigurimit teknik. Në kryerjen e te gjitha operacioneve te punës, duhet të punësohen specialistë me eksperiencë e të kualifikuar në përputhje me kërkesat e vendit të punës. Operacionet e punës duhet te drejtohen nga përsoni kualifikuar I cili do të zbatoje rregullat e percaktuara ne rregulloren e teknikes se sigurimit per çdo rast.

Ne ketë rregullore percaktohen:

Detyrimete punëdhenesit

- Punedhenesi vetë ose nepermjet drejtuesit teknik duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:
- Pajisjet dhe automjetet që përdoren në operacionet e ngarkim shkarkimit.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre sipas specifikes se aktivitetit.

- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune në R epubliken e Shqiperisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të leshuara nga dikasteret që lidhen me to.
- Veçoritë e punës në, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes për menjanimi ne aksidenteve sidomos në kushte të veçanta (reshje,lageshtire etj).
- Rregulla te sigurimit teknik që lidhen me proçeset e punes, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjesve të tjerë, të cilët kryejnë ketë aktivitet ose të tjerë që janë vizitore.
- Ndihmen e parë shendetsore
- Të kryeje instruktim paraprak dhe periodik të punonjesve, dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik për operacione specifike të aktivitetit.

Detyrimet e punëmarrsit:

- Të njohëmirë përdorim e pajisjeve dhe makinerive për shfrytezimine tyre.
- Të njohë dhe zbatojë rregullore te sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektoriati I Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati I Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundeshme të aksidenteve per çdo proçes pune.
- Të siguroje vehtën e punonjesit e tjerë gjatë proçesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhë të parë, merr masa për eleminimin e saj, nderkohë lajmëron gjithë punonjesit pë rrrezikun.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuritë mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Firma zbatuese e punimeve, duhet te marri masa per trainimin e personelit per nderhyrje te shpejta ne rast avarish gjate procesit te punes si pas kerkesave te MNZ-se. Firma ndertuese duhet te zbatoje me rigorozitet kërkesate MNZ-se për te perfshirë brenda ketij projekti vendosjen e fiksave brenda ambjenteve te punes.

V. Manaxhimi i mjedisit, monitorimi

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Emetimet ne ajër	<u>Faza pas perfundimit te projekti</u> Nivelet e tanishme të grimcave (PM10) janë më të larta se standardet evropiane. Pritet qe zonat ë gjelberta do të ketë një ndikim të ndjeshem pozitiv mbi cilësinë e ajrit për vetë rolin biologjik te bimësisë .	<u>Faza pas perfundimit te projekti</u> Masat zbutese varen nga plani i përgjithshëm mbi mbrojtjen e zhvillimin e zonave te gjelberta per ajrit për qytetin e Tiranës	<u>Faza pas perfundimit te projekti</u> Sherbimet publike të Bashkisë, Gjelberimi i qytetit.	<u>Faza pas perfundimit te projekti</u> Kostoja është pjesë e zgjidhjeve të projekti, kosto e projektit.	<u>Faza pas perfundimit te projekti</u> Zona është pjesë e sistemit të monitorimit të qytetit.
	<u>Faza e ndërtimit</u> Mund të shfaqen nivele të larta të ndotjes nga pluhuri	<u>Faza e ndërtimit</u> Ngarkesat e kamionëve do të mbulohen për të parandaluar emetimet e pluhurit. Lagia e kalimeve aktive. Hapjet e sistemimi i shesheve të bëhën me regjim të lagur, (lagie me uji ne forme dushi). Po kështu të veprohet për rastet e prishjeve të objekteve si dhe evadime dherash e mbetjesh e aktivitete ndertuese që formojnë pluhura.	<u>Faza e ndërtimit</u> Firma zbatuese,	<u>Faza e ndërtimit</u> Pa kosto shtese ne projekt	<u>Faza e ndërtimit</u> Monitorime mjedisore të jashtme dhe mbikqyrje e punimeve

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Zhurma	Faza pas perfundimit te projekti Pritet të ulen nivelet e zhurmave sidomos nga sistemimi i parkingjeve. Synohet te arrihen standardet e zhurmës të OBSh (45 dBA) natën). Projekti disiplinon parkimin e levizijen.	Faza pas perfundimit te projekti Barrierat e zhurmës janë një opsion i papërshtatshëm. Dritaret me dopio xham që izolojnë zhurmat në zonën me ndërtesa shumëkatëshe mund ta reduktojnë zhurmën në nivelin e pranuar të zhurmës gjatë natës (sipas standardeve të OBSh)	Faza pas perfundimit te projekti Ndermarrja e gjelberimit, komuniteti.	Faza pas perfundimit te projekti Dritare që pengojnë zhurmat (500 apartamente me 2 dritare secili do të kushtonin afërsisht EUR 1M^2.	Faza e funksionimit
	Faza e ndërtimit Zhurmë intensive jo e vazhdueshme për shkak të punimeve të ndërtimit.	Faza e ndërtimit Ndalimi i punës gjatë natës me përjashtim kur justifikohet nga rrethana të veçanta.	Faza e ndërtimit Firma zbatuese	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit Monitorime mjedisore të jashtme dhe mbikqyrje e punimeve përfshirë matjet periodike të zhurmave

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Vibrimet	Faza pas perfundimit te projekti Pa ndikim të vibruese mbi Banesat.				
	Faza e ndërtimit Ndikim i mundshëm mbi banesat dhe mirëqenien e njerëzve	Faza e ndërtimit Ndalimi i punës gjatë natës me përjashtim kur justifikohet nga rrethana të veçanta. Në zonat sensitive rishikohen të dhëna bazë për gjendjen e ndërtesave ekzistuese.	Faza e ndërtimit Firma zbatuese		Faza e ndërtimit Monitorime mjedisore të jashtme dhe mbikqyrje e punimeve

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Fauna dhe Flora – Habitatet Korridoret ekologjike	Faza pas perfundimit te projekti Krijohet nje mjedis ekologjik I përshtatshëm per një bimesi e faunë përgjithësisht të menaxhuar me ndikim mjaft pozitiv ne komunitet.	Faza pas perfundimit te projekti Konfigurimi i peisazhit për të optimizuar habitatet (shih masat më sipër)	Faza e funksionimit Ndermarrja e gjelberimit, Bashkia, Komuniteti.	Faza e funksionimit	Faza e funksionimit
	Faza e ndërtimit Nuk ka humbje e tjetersim habitatit, si dhe për florën e faunën;	Faza e ndërtimit (Shih masat për administrimin e ujrave e të shkarkimeve)	Faza e ndërtimit Firma zbatuese	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Ndikimet sociale dhe ekonomike – Bizneset dhe aktivitetet ekonomike	Faza pas perfundimit te projekti Pa ndikim negativ; me ndikime pozitive (më shumë shërbim, më shumë efiçëncë e më shumë komoditet e mireqenie.	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti
	Faza e ndërtimit Ndikimi pozitiv lidhet me punësimin për punonjësit e ndërtimit	Faza e ndërtimit Nuk ka humbje biznesesh e aktivitete social e ekonomike	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Humbja e tokes dhe e struktures se saj	Faza pas perfundimit te projekti Nuk ka humbje te tokes por miradministrim urban te terrenit dhe formimi I mjedisve të gjelberta e sportive	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti	Faza pas perfundimit te projekti
	Faza e ndërtimit Largim e evadim te volumeve terreni te degraduar	Faza e ndërtimit Nuk do te kete raste qe te zgjidhennëpërmjet mekizmave financiar e ligjor	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit	Faza e ndërtimit

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Efekti barrierë	Faza pas perfundimit te projektit Barriera të mundshme për mbrojtjen e mjediseve sportive e të gjelberta	Faza pas perfundimit te projektit Koridore te veçanta për këmbësorët, vende të posaçme per parkim e vende sportive.			

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Ndikimet në burimet natyrore	Pa ndikime direkte ne burimet natyrore, por zhvillim te gjelberimit.				

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Peisazhi	Faza pas perfundimit te projektit Ndikime të fuqishme pozitive mbi peisazhin dhe burimet pamore, eleminimi i pamjeve te terreneve te pasistemuara .	Faza pas perfundimit te projektit Zona të gjelbëruara e e kende sportive harmonizohen kënshëm me objektet ndertimore funksionale.	Faza pas perfundimit te projektit Sherbimet publike te B. Gjelberimi i qytetit.	Faza pas perfundimit te projektit	Faza pas perfundimit te projektit Monitorim i mirëmbajtjes së elementeve me ndikim pozitivë në pejsazh
	Faza e ndërtimit Humbje pamore e hapesires, pëngim i pamjes se pejsazhit	Faza e ndërtimit Tregohet kujdes ne organizimin e punimeve e hapesirave pa rritur konfuzionin pamor. Rrethimi me elemente që pengojnë sadopak pamjen ne sektorit ku punohet.	Faza e ndërtimit Investitori	Faza e ndërtimit Kosto perfshihet ne vleren e zbatimit të projektit	Faza e ndërtimit Monitorim mni respektimin rigoroz te projektit

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Ujrat (cilësinë e ujrave nëntoksore, praninë dhe sasisën e ujrave nëntosore e siperfaqësore)	Faza pas perfundimit te projektit Eleminohet mundesi e derdhjeve te pakontrolluara pasi mjedisi eshte I sistemuar e kontrolluar.	Faza pas perfundimit te projektit Mirëmbajtja e mjediseve të objekteve. Adminsitrimi I të gjitha llojeve të mbetjeve konform kerkesave specifike ligjore.	Faza pas perfundimit te projektit Sherbimet publike te B. Tiranes, Uj. Kanalizimet, Gjelberimi i qytetit	Faza pas perfundimit te projektit Përfshihet në kostot e sherbimeve të mirëmbajtje s	Faza pas perfundimit te projektit Mon itorim i jashtëm

	Faza e ndërtimit Mundësia e derdhjeve mbi tokë dhe infiltrimi i ndotësve/konta minuesve në tabanin e ujrave nëntokësore	Faza e ndërtimit Pastrimi i mënjehershëm vatrave që përkohësisht mund të ndoten nga aktiviteti ndertues. Respektimi rigoroz i projektit në ndërtimin dhe vënien në funksion të sistemit drenues të ujrave të shiut, kanalizimit të ujrave të zeza. Evitimin e rasteve të shperlarjes së mbetjeve ndotese nga ujrat e shiut, duke adminsitru në mënyrë të përshtshem e konform ligjit I të gjitha llojeve të mbetjeve.	Faza e ndërtimit Firma zbatuese	Faza e ndërtimit Përfshirë në projekt	Faza e ndërtimit

Ndikimi	Pershkrimi i ndikimit	Masat e zbutjes dhe kompensimit	Pergjegjesia	Kosto	Masat monitoruese
Trashigimia kulturore	Pa ndikim, ne sheshin e ndertimit nuk ka monumente, objekte kulti etj. Faza e ndertimi Gjetje rastësore gjatë kryerjes së punimeve të zhvendosjes së dheut	Faza pas perfundimit te projektit Procedura e njoftimit dhe vlerësimit për gjetjet rastësore	Faza pas perfundimit te projektit Kontraktori Ministria e Kulturës	Nuk ka	Faza e ndërtimit Mbikëqyrësi i punimeve dhe monitorimi nga Bashkia.

Monitorimi i mjedisit. Per çdo rast te ndryshimeve potenciale ne mjedis, te paparashikuara, si rezultat i aktivitetit, administratori qe eshte pergjegjes ne zbatimin e punimeve duhet te marre masa mbrojtese dhe te njoftoje menjehere DRM Tiranë, me qellim mbajtjen nen kontroll te situates ne perputhje me standartet mjedisore.

Konkluzione.

Ne RaportineVleresimit te Ndikimit ne Mjedis është parashikuar zbatimi i projektit duke pasur parasysh te gjitha kushtet per mbrojtjen e mjedisit, bazuar ne:

- Ligjin nr.10431,datë9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i cili përcakton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejes mjedisore;
- Ligjin nr.10440, datë7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces dhe mënyrëne miratimit të lejes mjedisore;

Po kështu ky raport bazohet në të gjithë kuadrin ligjor mjedisor për vëndin tonë.

Ky raport kontrollohet nga organet shteterore kompetente.

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shoqerohet me ndikime potenciale negative ne mjedis por ndikon fuqishem ne permirsimin e tij.

Masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të projektit të parashtruara në ketë raport jane te plota per minimizimin e ndikimeve ne mjedis.

Aktiviteti kontribuon ne përmirsimin e qarkullimit rrugore te kembesoreve ne zonën e Laprakës, rrit sigurinë si dhe zhvillon akoma më shumë ketë zonë në harmoni me aspektet e tjera të zhvillimit urban të të gjithë qytetit të Tiranes.

KULD shpk me nr. Nipti K88304501J

License e QKL-se nr. LN-7295-01-2014

Date 16.04.2016

EKSPERT MJEDISI

Jak GJINI

Çertifikuar sipas Vendimit Nr. 10,

datë 24.07.2008 të me nr. 531

Prot. nga Ministria e Mjedisit.